

Siguri

# Me armën e babait dyshohet se u krye krimi në Malishevë – Policia e gjeti në vendngjarje, familjari deklaroi se e kishte me leje



Sinjali.com

24 Gusht 2026 09:37



**Detaje të reja janë zbuluar për tragjedinë në Kërvasari të Malishevës, ku 24-vjeçarja Jetlira Foniqi Bytyqi humbi jetën pasi u plagos me armë zjarri, ndërsa bashkëshorti i saj, Egzon Bytyqi, 26 vjeçar, po trajtohet si i dyshuar në rastin që është iniciuar si “Vrasje e rëndë”.**

Sinjali mëson se arma që dyshohet se është përdorur në këtë rast i përket babait të të dyshuarit.

Sipas informacioneve që ka siguruar Sinjali, Policia e ka gjetur armën në vendin e ngjarjes, ndërsa babai i Egzon Bytyqit ka deklaruar para autoriteteve se armën e posedonte me leje.

Ngjarja e rëndë ka ndodhur mbrëmjen e 23 gushtit, rreth orës 23:00, kur Policia është njoftuar për një plagosje me armë zjarri në fshatin Kërvasari.

Patrullat policore dhe ekipet e Emergjencës së QKMF-së në Malishevë janë nisur menjëherë drejt lokacionit, ku Egzon dhe Jetlira Bytyqi janë gjetur të plagosur me armë zjarri brenda dhomës së gjumit.

Të dy janë dërguar me urgjencë në QKUK në Prishtinë për trajtim mjekësor.

Por për Jetlirën plagët rezultuan fatale.

Rreth orës 01:10, nga Emergjenca e QKUK-së është konfirmuar se 24-vjeçarja kishte ndërruar jetë.


Ndërkohë, në shtëpinë ku ndodhi ngjarja, hetuesit kanë gjetur armën që dyshohet se është përdorur. Ajo është sekuestruar dhe pritët të jetë një nga provat kryesore materiale në hetimin për zbardhjen e plotë të rastit.

Në vendngjarje kanë dalë hetuesit policorë, drejtues të Policisë dhe Prokurori i Shtetit nga Departamenti për Krime të Rënda.

Me urdhër të Prokurorit, rasti është iniciuar si “Vrasje e rëndë”, ndërsa hetimet po vazhdojnë për të përcaktuar dinamikën e saktë të ngjarjes dhe rrethanat në të cilat është përdorur arma.

Sipas të dhënave të rastit, i dyshuari kishte punuar prej rreth katër vitesh në Gjermani dhe ishte kthyer në Kosovë rreth një muaj më parë. Familjarët kanë dhënë deklarime edhe për gjendjen e tij shëndetësore gjatë kohës së fundit, pretendime të cilat mbeten për t’u verifikuar nga organet kompetente.

Fakti se arma dyshohet se ishte e babait dhe se ai deklaroi se e posedonte me leje tashmë është pjesë e mozaikut të provave që hetuesit duhet ta zbërthejnë për të përcaktuar se çfarë ndodhi atë natë brenda dhomës së gjumit.

**Lexo edhe****Ekskluzive | Ky është i dyshuari për vrasjen e rëndë në Malishevë – gruaja 24-vjeçare vdiq pasi çifti u gjet i plagosur**

<https://sinjali.com/e-trishte-kjo-eshte-24-vjecarja-qe-humbi-jeten-tragjikisht-ne-malisheve-u-gjet-e-plagosur-me-arme-ne-dhomen-e-gjumit>

**Lexo edhe****Tragjedi familjare në Malishevë | Çifti gjendet i plagosur me armë në dhomën e gjumit – 24-vjeçarja vdes në QKUK,**

**Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.**

**Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!**

**/GazetaSinjali/**

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.

**Lajme**

Zgjedhjet 2026  
Kosovë  
Shqipëri  
Rajon  
Diasporë  
Evropë  
Botë

**Aktualitet**

Politikë  
Drejtësi  
Siguri  
Shëndetësi  
Arsim  
Sociale

**Hulumtime**

Ekskluzive  
Profile  
Skandaloze

**Ekonomi**

Prodhime Vendore  
Financa  
Biznes

**Sport**

Botërori 2026  
Futboll  
Basketboll  
Sporte Luftarake  
Sporte të tjera

**Showbiz**

Bota e Yjeve  
Modë & Stil  
Bukurri dhe kujdes  
Të tjera

**OP-ED**

Analizë  
Kolumne  
Intervistë

**Jetë**

Fitness  
Ushqime  
Travel  
Këshilla  
Receta  
Dieta  
Shëndeti

**Kulturë**

Film  
Muzikë  
TV & Radio  
Libra  
Art & Dizajn  
Fotografi  
Histori

**Tech & Auto**

Teknologji  
Automjete  
Telefona  
Lojëra  
Aplikacione

**Fun**

Qesharake  
Kuriozitete  
Kuize  
Fakte  
Të tjera